REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr.2331 Prot.

Krumë, me 07/07/2025

Në kuadër të ndërmarrjes së masave parandaluese dhe mbrojtjes nga zjarri në territorin e Bashkisë Has, ju drejtohemi me këtë:

APEL

Të nderuar qytetarë të Bashkisë Has, kemi hyrë në muajtë e temperaturave të larta dhe të thatësisë së madhe, mundësitë për shpërthim dhe përhapje të shpejtë e të pakontrolluar të zjarrëve, janë të mëdha.

Apelojmë te qytetarët që të kenë kujdes të shtuar gjatë kësaj kohe:

-të mos djegin hamullore,

-të ruajnë në mënyrë adekuate dhe të bëjnë magazinimin e materialeve të rrezikshme,

-materiet lehtëndezëse të ruhen në mënyrë adekuate sipas rregullave të magazinimit.

Ligji për Mbrojtjen nga Zjarri ndalon djegien e të korrave/hamullore, e mbeturinave dhe të mbetjeve bimore.

Ndalohet ndezja e zjarrit në pyje dhe pranë (rrëzë) pyllit, përveç në vende të caktuara, të shënuara dukshëm me mbikëqyrje të rreptë nga personat të cilët ndezin, si dhe sanimin e detyrueshëm të siperfaqëve ku është ndezuar zjarri.

Personi i cili shkakton zjarr, do të detyrohet që të kompensojë dëmin- të rimbursojë njësinë e Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit për koston e reagimit, si dhe bart pasojat ë përputhje me Ligjin për Mbrojtjen nga zjarri dhe dispozitat e ligjeve të tjera në fuqi.

Në të gjitha institucionet, ndërmarrjet punuese, pompat e benzinës dhe vende të tjera ku depozitohen karburante dhe mjete të tjera ndezëse, të rritet gatishmëria, të kontrollohen pajisjet për mbrojtjen nga zjarri, në mënyrë që të jenë të gatshme për përdorim, në rast nevoje.

Çdo qytetar është i obliguar të lajmërojë zjarrin në njesinë më të afërt të zjarrfikësve ose në stacionin policor , apo në numrat e telefonit:

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

112 – Shërbimi i Emergjencës.


127 – Ambulanca

128 – Shërbimi Zjarrëfikës.

129 – Policia e Shtetit.


Drejtoresha e Mbrojtjes Civile

Arbërie Rada



KRYETAR

Miftar DAUTI



***Adresa**: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al